



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-22380

Dt: 25.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 34 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarje të Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit nr.06-20027-11/4 të miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të dt: 15.04.2016, me të cilin është aprovuar kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për subvencionimin e projektit të OJQ Bethany Christian Services, për zhvillimin e aktiviteteve parashkolllore dhe shkollore në Qendrën e Komuniteteve në Brekoc , me dt: 25.04.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim e ndërlidhur me kërkesën nr. 16-400-7023 e dt. 08.02.2016 për subvencionimin e shpenzimeve të Qendrës për Komunitete në Brekoc, për realizimin e projektit të OJQ Bethany Christian Services“ Integrimi i respektuar i komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Gjakovës, përmes përmirësimit të pjesëmarrjes dhe cilësisë në arsim, si dhe shëndetit të popullatës, duke e mbështetur me subvencione komunale në vlerë prej 2.500€ .

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2.500€, nga linja e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në konton e OJQ Bethany Christian Services nr. 1505001000052757 –Raiffeisen Bank .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Z. Berat Thaçi , menaxher i Bethany Christian Services
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

spz aut 22/04/16

